

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6497
E shtunë, 25 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Diabgu Kosovë - Serbi që nuk po përfundon

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA E KOSOVËS KRITIKOHET PËR GJENDJEN E RËNDË ENERGETIKE | FAQE 4-5

QEVERIA SHPALL 60 DITË GJENDJE EMERGJENTE PËR FURNIZIM ME ENERGI



Subjektet opozitare e kanë fajësuar Qeverinë e Kosovës për krizën e rëndë energjetike në vend. Deputetët e këtyre partive kanë thënë se, pavarësisht prej paralajmërimit të hershëm për këtë krizë, qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta shmangur atë. Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka thënë se qeveria duhet të shpallë gjendje emergjente energjetike. Sipas tij, mbështetur në legjislacionin në fuqi, qeveria duhet të tregohet transparente para opinionit dhe qytetarëve për transaksionet qeveritare që po bën. Ndërkaq qeveria ka shpallur masa emergjente për kufizim të furnizimit me energji për 60 ditë

AKTUALE



DEDUSHAJ: 'OMICRONI'
DHE GRIPI STINOR, SHENJA
KLINIKE TË PËRAFËRTA F. 5

FSK-SË I SHTOHN EDHE 190
REKRUTË TË RINJ F. 6

MINISTRI LATIFI, MËRGMITARËVE:
DHURATA MË E MIRË QË MUND TË
SILLNI NË KOSOVË, TË JENI TË
VAKSINUAR F. 7

EKONOMI



BQK-JA THOTË SE SIVJET
PATI RITJE EKONOMIKE PREJ
9.9-PËRQINDËSH F. 8

KDI-JA: INVESTIMET KAPITALE
NË BALLKANIN PERËNDIMOR
DHE TURQI, ME RREZIK TË LARTË
TË KORRUPSIONIT F. 8

SPORT



KRYEMINISTRI KURTI: NUK DO TË
KURSEJMË PËR TA PËRFUNDUAR
INFRASTRUKTURËN E RE SPORTIVE
NË ZHEÇËR F. 10

Syla kërkon rritje
50 për qind të pagave
për punëtorët
shëndetësorë | FAQE 7



POROSIA E IPESHKVIT IMZOT DODË GJERGJIT PËR KRISHTLINDJE 2021

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Franca rekomandon dozën përforcuese vetëm 3 muaj pas dozave të para

PARIS, 24 DHJETOR - Franca ka rekomanduar të premtën, më 24 dhjetor, që të rriturit ta marrin vaksinën përforcuese kundër Covid-19, vetëm tre muaj pas dy dozave të para, duke ndryshuar udhëzimin që doza përforcuese të merrej pas pesë muajsh. Ky rekomandim ka ardhur si masë e re në luftën kundër variantit "Omicron". Rekomandimi është publikuar nga autoritetet shëndetësore

franceze, i cili këshillon qeverinë në luftën kundër Covid-19. Rastet në Francë po rriten gjatë periudhës së Krishtlindjeve për shkak se "Omicron"-i po përhapet më shpejt se çdo variant tjetër deri më tani. Dozën përforcuese, sipas rekomandimit, duhet ta marrin edhe adoleshentët. Ditë më parë Franca filloi fushatën për vaksinimin e fëmijëve të moshës nga pesë vjeç

e lart. Franca të enjten regjistroi 91 608 raste pozitive me Covid-19, një rekord që nga fillimi i pandemisë. Ndryshe nga disa vende të tjera evropiane, presidenti Emmanuel Macron deri më tani i ka rezistuar vendosjes së kufizimeve të reja të ashpra për ta luftuar variantin "Omicron", duke shpresuar se programi i dozave përforcuese do të parandalojë që sistemi shëndetësor të mbingarkohet.



Vdesin katër migrantë në Greqi



ATHINË, 24 DHJETOR - Të paktën katër persona kanë vdekur pasi një varkë me dhjetëra migrantë u fundos në veri-perëndim të ishullit të Kretës në Greqi, njoftoi roja bregdetare. Rreth 90 persona të tjerë arritën të dilnin në breg, tha të premtën një zëdhënës i rojës bregdetare për agjencinë e

lajmeve DPA. Roja bregdetare greke ka nisur një operacion shpëtimi për të shpëtuar jetët e migrantëve. Të mërkurën tre migrantë u mbytën kur një tjetër varkë u fundos në detin Egje pranë ishullit Folegandros. Dhjetëra njerëz që ishin në bordin e asaj varke ende nuk


janë gjetur. Aksidentet ndodhin teksa migrantët përpiqen të arrijnë në territorin e Greqisë ose Italisë, nga bregu turk i Egjeut. Sipas autoriteteve, rreth 11 000 njerëz kanë arritur në Itali gjatë muajve të fundit, derisa nuk ka shifra zyrtare se sa njerëz kanë vdekur.

Sëmuret personeli, anulohen qindra fluturime në botë

BERLIN, 24 DHJETOR - Të paktën tri kompani ajrore kryesore botërore kanë raportuar anulimin e dhjetëra fluturimeve pasi sëmundjet e lidhura kryesisht me variantin "Omicron" të Covid-19 kanë ndikuar në uljen e numrit të personelit të ekipazhit të fluturimeve në prag të sezonit të ngarkuar të udhëtimeve për festat e fundvitit. "Lufthansa", me bazë në Gjermani, tha të premtën se po anulonte dhjetëra fluturime të gjata transatlantike gjatë periudhës së festave të Krishtlindjes për shkak të një "rritjeje masive" të pushimeve mjekësore në mesin e pilotëve. Anulimet e fluturimeve për në Hjuston, Boston dhe Uashington të ShBA-së, pasojnë pavarësisht

prej rritjes së numrit të stafit për këtë periudhë. "Lufthansa" tha në një deklaratë se me gjithë përgatitjet, operimi i fluturimeve ishte i pamundur për shkak të numrit të madh të punonjësve që u paraqitën të sëmurë. Në ShBA, "Delta Air Lines" dhe "United Airlines" thanë se janë të obliguara të anulojnë dhjetëra fluturime në prag të Krishtlindjes për mungesë stafi si pasojë e prekjes nga sëmundje të lidhura me variantin "Omicron". "Rritja mbarëkombëtare e rasteve me 'Omicron' këtë javë ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në ekipazhet tona të fluturimit dhe njerëzit që drejtojnë operacionet tona", tha "United Airlines" në një deklaratë për medie. "Si rezultat,

për fat të keq, na është dashur të anulohet disa fluturime dhe po i njoftojmë klientët e prekur para se të vijnë në aeroport", thuhet në njoftimin e "United Airlines". Kjo kompani tha se po anulonte mbi 100 fluturime dhe po punonte për të ricaktuar në pozitë ku ka mungesa sa më shumë njerëz që të ishte e mundur. "Delta" tha se anuloi rreth 90 fluturime të premtën për shkak të mundësisë së motit të keq dhe si pasojë e ndikimit të "Omicron"-it pasi kishte "shtruar të gjitha opsionet dhe burimet, duke përfshirë ndryshimin e rrugës dhe zëvendësimin e avionëve dhe ekipazheve për t'i mbuluar fluturimet e planifikuara". Anulimet e fluturimeve po



ndodhin për shkak të shtimit të rasteve të punonjësve të prekur nga koronavirusi, të nxitura kryesisht nga varianti i ri "Omicron". Vende si Spanja dhe Britania e Madhe kanë shkurtuar

kohëzgjatjen e karantinave të Covid-19 për ta lehtësuar mungesën e personelit duke i lejuar njerëzit të kthehen në punë më shpejt pasi kanë dalë pozitivë ose janë ekspozuar ndaj virusit.

Shtrëngohen masat kundër Covid-19 në Çeki

PRAGË, 24 DHJETOR - Republika Çeke ka një muaj që është në gjendje të jashtëzakonshme të shpallur nga qeveria më 25 nëntor për shkak të rritjes së rasteve me Covid-19. Për shkak të kësaj gjendje janë rikthyer kufizimet e ashpra për ta përmirësuar gjendjen me virusin.

Të mërkurën, më 22 dhjetor, qeveria njoftoi se një sërë masash të tjera do të hyjnë në fuqi që nga 29 dhjetori. Sipas këtyre masave, në festat e Vitit të Ri lejohen jo më shumë se 50 persona dhe të gjithë pjesëmarrësve duhet t'u kontrollon certifikatat e Covid-19.



Nga 29 dhjetori deri më 2 janar në tavolina të

restoranteve nuk mund të ulen më shumë se katër persona, me përjashtim të atyre që janë nga e njëjta familje. Në ngjarjet kulturore lejohen maksimum 1 000 njerëz, kurse në të tjerat ku njerëzit nuk ulen në karrige, nuk lejohen më shumë se 100

persona. Sipas institucioneve shëndetësore çeke, numri i rasteve të reja me koronavirus ka filluar të bie. Për qindja e popullsisë çeke që ka marrë dy dozat e vaksinës është 61.4 për qind, krahasuar me 67.8 për qind për të gjitha shtetet e BE-së.

DIALOGU KOSOVË - SERBI QË NUK PO PËRFUNDON



PRISHTINË, 24 DHJETOR - Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, do të duhej të përfundonte me sukses tash e një kohë. Kur ka nisur mandatin Mirosllav Lajçak, i dërguari i posaçëm i BE-së për këtë dialog më 2020, ai ka thënë me besim të plotë synon të arrijë marrëveshje përfundimtare brenda muajve, jo viteve. Ai me raste ka qenë edhe më optimist, duke thënë se palët duhet të ulen për të biseduar së bashku për një javë dhe të merren vesh për të gjitha hollësitë.

Megjithatë, ja ku jemi. Bisedimet kanë shënuar pak përparim më 2021.

Kjo për fajin e një dështimi të jashtëzakonshëm të Bashkimit Evropian që nuk ka arritur ta menaxhojë këtë situatë.

Ballkani Perëndimor është, si në aspektin politik, ashtu edhe në atë gjeografik, në oborr të bllokut evropian, dhe ndonëse tani janë krijuar kushtet për marrëveshje, BE-ja nuk e ka fuqinë që të arrijë diçka të tillë kryesisht për shkak të çështjeve të brendshme.

Dhe në këtë gjë as mos dyshoni. Palët janë në qiellin e njëjtë politik tani për tani. Si në Prishtinë, kryeministri, Albin Kurti ashtu edhe në Beograd,

presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, tani janë liderë të pakontestueshëm.

Ata kanë mandate politike për të arritur marrëveshje, me jo shumë mosmarrëveshje nëpër vendet e tyre.

Mandati i përbërjes aktuale të Komisionit Evropian zgjat deri më 2024, prandaj të gjithë aktorët e sagës, duke nisur nga presidentja e KE-së, Ursula von der Leyen, shefi i BE-së për Politikë të Jashtme, Josep Borrell, janë duke hyrë në mes të mandatit kur po ndodhin këto çështje të mëdha.

Jashtë territorit të saj BE-ja e ka në krah një Shtëpi të Bardhë bashkëpunuese, e cila është në linjë me Brukselin sa i përket Ballkanit Perëndimor dhe një president amerikan i cili ka edhe tre vjet për ta riparuar lidhjen e dëmtuar transatlantike.

Tani skena është gati, por aktorët refuzojnë t'i kryejnë pjesët e tyre. Një mori zyrtarësh, kryesisht nga Brukseli, drejtojnë gishtin te Kurti.

Kokëfortë dhe i sigurt, ai, në krahasim me politikanët e tjerë kosovarë, ka qasje tjetër ndaj dialogut, të cilët shpesh janë akuzuar në shtëpi se janë duke iu përlur presionit të Serbisë.

Tani Vuçiqi ka dikë tjetër

përballë.

Në dialogun e nivelit më të lartë në Bruksel këtë vit, Kurti ka habitur si Beogradin, ashtu edhe Lajçakun, duke kërkuar drejtpërdrejt që bisedimet të fokusohen në njohje tabu diplomatike më parë, dhe se Kosova duhet të jetë subjekt dhe jo objekt i këtyre bisedimeve.

Më vonë, pas një takimi të ekipit të Kosovës në Bruksel, është parë diçka e pazakontë.

Borrelli e ka qortuar Kurtin për dështim të zbatimit të një marrëveshjeje të nënshkruar vite më parë për krijim të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Dhe jo vetëm kaq. Borrelli, në vend që të ishte ndërmjetësues neutral, ai ka pozicionuar veten në anën e Beogradit dhe ka qenë hapur antagonist ndaj një bashkëbiseduesi, diçka e pazakonshme për një kryediplomat të bllokut evropian. Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në veri të Kosovës është çështja kyçe që po bllokton tani procesin e dialogut.

Serbia është duke insistuar në zbatimin e plotë të marrëveshjes dhe nuk i intereson pse Prishtina përmend mungesën e zbatimit të gati të dy të tretave të marrëveshjeve të arritura në

dekadën e fundit.

Nuk i bën përshtypje as që Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka hedhur poshtë idenë e këtij Asociacioni, pas shqetësimeve se ai mund të krijojë një situatë të ngjashme sikurse Republika Sërpska në Bosnjë e Hercegovinë, entitet që jo vetëm po frenon përparimin e shtetit, por edhe është de fakto nën komandën e Beogradit.

Ndonëse Serbia dhe Bashkimi Evropian kanë të njëjtën mendim, ende ka pak mundësi që të shohim zhblokim më 2022.

Shtetet e Bashkuara pritet ta rritin presionin ndaj Kurtit, dhe ndonëse ai mund të ketë ardhur në përfundim se politikisht ka pak mundësi që të fitojë nga një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, megjithatë dëshiron që Uashingtoni të ketë pikëpamje të mirë për të.

Prandaj, askush nuk duhet të befasohet nëse arrihet një marrëveshje e përhershme për targarë e makinave, që pothuajse çoi të dyja shtetet në konflikt më 2021.

Nëse një arritje e tillë do të mund të rezultojë me përparim të mëtejshëm, nuk e di askush, mirëpo bisedimet kanë pak mundësi të kenë një epilog. Dhe kjo edhe për faktin se Brukseli ka

pak për të ofruar për të dyja palët.

Edhe nëse Serbia i jep fund marrëdhënies së saj me Kosovën para anëtarësimit në BE, ende do t'i duhet të paktën edhe një dekadë për t'u bërë pjesë e bllokut evropian.

Procesi i zgjerimit nuk ka shumë siguri në vete, andaj pse Vuçiqi do ta prishte imazhin e tij në Serbi, duke e tregtuar çështjen e Kosovës me një rrugë të paqartë drejt Brukselit?

Po Kosova çka fiton? Është edhe më poshtë në renditjen e vendeve të ardhshme në BE. Jemi duke diskutuar për dekada këtu. Ajo çfarë dihet me siguri tani është se Brukseli nuk po mund të realizojë dy gjëra për Prishtinën në këtë kohë: liberalizimin e vizave dhe njohjen e shtetësisë.

Sa i përket të parës, disa vende anëtare thjesht nuk duan të veprojnë, ndërsa sa i përket të dytës, Qiproja dhe Greqia mbeten më kundër se kurrë për njohjen e shtetësisë së Kosovës si shtet sovran.

Por kjo nuk nënkupton se tri vendet e tjera mosnjohëse, Rumania, Sllovakia dhe Spanja, do të veprojnë ndryshe.

Brukseli është i pafat për këto çështje dhe këtë situatë pritet ta përjetojë edhe më 2022.



QEVERIA E KOSOVËS KRITIKOHET PËR GJENDJEN E RËNDË ENERGJETIKE

Qeveria shpall 60 ditë gjendje emergjente për furnizim me energji

Subjektet opozitare e kanë fajësuar Qeverinë e Kosovës për krizën e rëndë energjetike në vend. Deputetët e këtyre partive kanë thënë se, pavarësisht prej paralajmërimit të hershëm për këtë krizë, qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta shmangur atë. Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka thënë se qeveria duhet të shpallë gjendje emergjente energjetike. Sipas tij, mbështetur në legjislacionin në fuqi, qeveria duhet të tregohet transparente para opinionit dhe qytetarëve për transaksionet qeveritare që po bën. Ndërkaq qeveria ka shpallur masa emergjente për kufizim të furnizimit me energji për 60 ditë

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOÇI

Prishtinë, 24 dhjetor - Deputetët e partive opozitare e kanë fajësuar qeverinë për krizën energjetike me të cilën po përballet Kosova. Në seancën e së premtes, ata kanë thënë se mosveprimi i qeverisë e ka sjellë vendin në këtë krizë të thellë energjetike. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka deklaruar se kriza energjetike do të krijojë humbje qindramilionëshe për Kosovën. Ai ka kërkuar shpalljen e gjendjes emergjente energjetike. "Kjo situatë ka dy kuptime, diskriminimi po ndodh pasi në veri të vendit

s'ka reduktime e ndalje të rrymës, vijmë deri te pyetjet se cilat janë veprimet që do t'i ndërmarrë qeveria. Nëse s'ka ide, të marrë modele nga shtetet përreth. Ku janë rekomandimet e task-forcës, se veprimet e saj s'po i shohim. Për shkak të paaftësisë, i themi Kurtit ta shpallë gjendjen emergjente dhe të lirojë nga detyra një pjesë të kabinetit që mbulojnë sektorin e energjisë", ka thënë ai. Sipas tij, përgjegjëse kryesore për krizën energjisë është qeveria, assesi qytetarët. "Përgjegjësjë kryesore është Qeveria e Kosovës me të gjithë sektorët dhe dikasteret që mbulojnë këtë sektor të energjisë. A i ka kryer detyrat dhe obligimet

karshi kësaj krize. Me përgjegjësi të plotë themi se jo. Mungesa totale e një planifikimi të një shtate të tillë, përkundër paralajmërimeve të hershme, mungesa mobilizuese ndërinstitucionale. Paaftësia e skajshme vendimmarrëse e kësaj qeverie, orientimi i tërë kapacitetit qeveritar drejt identifikimit të zbulimit të ashtuquajturit fajtor historik, parti dhe qeveri të kaluara, procese dhe individë të caktuar, për të ardhur në përfundimin final se fajtorë janë qytetarët që po kërkojnë shërbim dhe ngrohje gjatë stinës së dimrit. Kulmi i injorancës është ky konstatim", ka thënë Shala. Edhe deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka deklaruar se qeveria duhet të bëjë politika proaktive për t'i parandaluar krizat. "Kemi parë tash e 10 muaj një qeveri që reagon për probleme dhe nuk ka një situatë ku ndërton politika proaktive ndaj problemeve që dihen. E kemi ditur që gjashtë muaj që do të kemi krizë me energji dhe tash ka një reagim për këtë dhe nuk ka strategji për ta parandaluar këtë krizë", ka deklaruar Tahiri. Ndërsa Partia Socialdemokrate

ka mbajtur një aksion simbolik para ndërtesës së qeverisë, duke ngritur batanije në vend të flamujve. Me këtë rast, aktivistja e PSD-së, Natyra Kuqi, Qeverinë e Kosovës e ka quajtur "Qeveria e Kosovës". "Ashtu siç ngritet flamuri i bardhë në momentet e dorëzimit, sot i ngritëm qeben Kurtit si simbolikë e dorëzimit të tij karshi kapitalit privat që është KEDS-i e në kurriz të qytetarëve të Kosovës. Lloj-lloj shembujsh për tejkalimin e krizës së energjisë i kemi dëgjuar nga Kurti e vartësit e tij. Çka i karakterizonte të gjitha ato, prej qebes e akuza për komoditet e deri te reduktimi si zgjidhja e vetme përfundimtare, është shfajësimi i pushtetit e fajësimi i qytetarëve. Është ky pushtet që sot i ka ndarë 45 milionë euro për KEDS-in", ka thënë ajo. Sipas saj, qebja e qiri janë simbole të kësaj qeverie. "Është ky pushtet që po detyron qytetarët ta paguajnë dyfish energjinë elektrike e cila po u mungon në shtëpitë e tyre. Është kjo qeveri që i është dorëzuar plotësisht KEDS-it, pra privatit, në kurriz të publikes, pra qytetarëve. Qebja e qiri do të mbesin simboli i një dimri të ftohtë, simbol i një

ekonomie të shkatërruar, simbol i një qeverie të dështuar", ka deklaruar Kuqi. Që nga e mërkura qytetarët në Kosovë po përballesh me reduktime të energjisë elektrike. Situata energjetike është përkeqësuar pasi konsumi i energjisë ditët e fundit ka shënuar rritje për 14 për qind. Ky konsum nuk mund të mbulohet nga kapacitetet prodhuese të Korporatës Energjetike të Kosovës. Nga ajo ditë KEDS-i ka nisur aplikimin e reduktimeve në të gjithë vendin. Ndonëse paralajmërimi ka qenë që ato do të jenë vetëm dy orë, reduktimi ka zgjatur deri në 6 orë në ditë. Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për shpalljen e masave emergjente për kufizimin me energji elektrike në kohëzgjatje prej 60-ditësh pas krizës energjetike që e ka kapluar së fundmi vendin. Sipas dokumentit të publikuar nga zyra e kryeministrit, masat emergjente për furnizim me energji përfshijnë vendosjen e kufizimeve për furnizim me energji për konsumatorët dhe vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë. Qeveria, po ashtu, përmes këtij vendimi ka vendosur edhe për

Dedushaj: 'Omicroni' dhe gripi stinor, me shenja klinike të përafërta

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Epidemiologu nga Kosova, Isuf Dedushaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se situata epidemiologjike me Covid-19, edhe pse aktualisht është e qetë në Kosovë, ka tendenca të përkeqësohet. Ai ka thënë se numri i madh i të infektuarve me grip stinor, mbi 15 mijë, ka krijuar sfidë të dyfishtë për ekspertët shëndetësorë. "Shenjat klinike të gripit A [gripit stinor] janë shumë të ngjashme dhe të përafërta me koronavirusin. Kështu që do të kemi edhe një problem më shumë me gripin sezonal për arsye se ai manifestohet me temperaturë deri në 40 gradë. Manifestohet me dhembje të kyçeve, heqje

të barkut, me dhembje të muskujve dhe në nyje. Kështu që janë të ngjashëm [me koronavirusin], por te gripi nuk ka nevojë për oksigjenoterapi", ka thënë Dedushaj.

Gjyle Mulliqi-Osmani, mikrobiologe e pensionuar në Kosovë, thotë se ngjashmëritë e variantit "Omicron" me gripin stinor janë mjaft të mëdha në aspektin klinik. "...sepse ka edhe rrjedhje hunde, ka edhe ënjtje të mukozave, të rrugëve respiratore, nuk ka gjithëherë temperaturë, ka dhembje, sikurse që ka edhe me virus të gripit, ka dhembje të muskujve sikurse edhe me virus të gripit. Prandaj, dallimi më i mirë dhe

më i preferuar do të ishte me diagnozë laboratorike. Por klinikisht, zakonisht, është mjaft vështirë që krejtësisht dhe me siguri 100 % të dallohen", ka thënë Mulliqi-Osmani për "Rel". Sipas saj, me testet që aktualisht kanë laboratorët publikë dhe privatë në Kosovë, mund të diagnostikohet infeksioni me virusin SARS Cov-2, që e shkakton sëmundjen Covid-19, por në këta laboratorë nuk mund të bëhet dallimi i shtamit [varianti brenda llojit] gjenetik të virusit, rrjedhimisht edhe varianti "Omicron".

Megjithatë, shton Mulliqi-Osmani, testimi për SARS Cov-2, ndonëse nuk mund t'i

dallojë varietetet, mund ta konfirmojë infektimin ose jo me koronavirus. Në këtë mënyrë, sipas saj, testimi i heq mëdyshjet nëse infeksioni është me koronavirus apo me grip stinor. Gjithashtu, thotë ajo, testimi mund të bëhet edhe për virusin Influenca A apo gripin stinor në mënyrë që të verifikohet diagnoza.

Mostrat nga testet PCR për koronavirus, të cilat dërgohen në laboratorë për analiza, mund të tregojnë nëse varianti që shkakton infeksionin duket si "Omicron".

Për zbulimin e rasteve me "Omicron" përdoret një teknologji e posaçme.

Për të konfirmuar se një rast i dyshuar është "Omicron"

duhen analiza të plota gjenetike, që zgjasin nga katër deri në pesë ditë.

IKShPK-ja ka konfirmuar se kitet e testeve PCR, të cilat mund ta detektojnë variantin "Omicron", pritet të arrijnë në Kosovë gjatë ditës së enjte.

"Varianti 'Omicron' i SARS-CoV-2 mund të detektohet me RT PCR test, që në mënyrë specifike e shënjon ndonjë nga mutacionet e S-proteinës së SARS-CoV-2. RT dhe PCR kitet e këtyre, të porositura nga IKShPK, pritet të arrijnë në Aeroportin e Prishtinës më 23.12.2021 dhe varet nga procedurat e zhdoganimit se sa shpejt do të arrijnë në IKShPK", thuhet në përgjigjen e këtij instituti.



themelimin e komitetit teknik emergjent në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë me qëllim të identifikimit dhe paraqitjes së rekomandimeve Ministres së Ekonomisë. Ky komitet do të përbëhet nga një përfaqësues i ministrisë së Ekonomisë, një nga ZRRE-ja, një nga KOSTT-i, një nga KEK-u, një nga KEDS-i, një nga KESCO, një nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, një përfaqësuese nga MPB-ja, një nga Komisioni për Miniera dhe Minerale dhe një anëtarë nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.

Qeveria mund ta tregojë shkaktarin e krizës energjetike pasi ta zgjidhë atë

Qasja e qeverisë ndaj krizës energjetike është kritikuar edhe nga njohësit e rrethanave politike në vend. Avokati i njohur, Dastid Pallaska, ka vlerësuar se qeveria mund ta tregojë shkaktarin e krizës energjetike vetëm pasi që ta zgjidhë problemin. "Qeveria edhe mund të tregojë kush e ka

shkaktuar problemin energjetik, por vetëm pasi që ta ketë zgjidhur atë! Kështu veprohet kur qeverisja është mbi politikën ditore", ka shkruar Pallaska në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa politologu Agon Maliqi ka thënë se qasja e tipit "na e lanë këta tjerët keq", të cilën është duke e përdorur qeveria

aktuale, është e pashije. "Kanë shumë përgjegjësi qeveritë e kaluara për gjendjen në sektorin e energjisë, mbi të gjitha për dështimin e projektit 'Kosova e Re' në vitet 2008-09, që është ndër mëkatet më të mëdha të PDK-së, por është e pashije qasja e tipit 'na e lanë këta tjerët keq', sepse e njëjta logjikë arsyetuese mund

të vlejë për çdo qeverisje të shkuar. Pse në çfarë gjendje na e la Kosovën Serbia? A d.m.th kjo që edhe qeveritë e kaluara nuk e paskan pasur aq lehtë kur kritikoheshin? Kush kërkon pushtet duhet të jetë i gatshëm të përballet me realitetin që e gjen dhe jo realitetin që e dëshiron", ka shkruar Maliqi në "Facebook".

Porosia e Ipeshkvit Imzot Dodë Gjergjit për Krishtlindje 2021

- Drejtuar priftërinjve, motrave të nderit, besimtarëve dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë në Kosovë

“Lavdi Hyjit në më të lartin qiell e paqe mbi tokë njerëzve që i ka për zemër!” (Lk 2,14).

1. Në prag të vigjiljes së festës së Krishtlindjes, kur e festojmë lindjen e Jezusit në Betlehem, po vij përsëri para jush për t’ju përcjell porosinë time të parvjetshme.

Të gjithë janë të ftuar ta kremtojnë këtë festë kaq të bukur të Kërshëndellave, mirëpo nuk duhet harruar se kjo festë nuk është thjesht një ditë sikur jemi mësuar t’i festojmë ditëlindjet tona, por një ngjarje shpëtimprurëse për njerëzimin. Kjo sepse nëpërmjet lindjes së Krishtit është përmbushur premtimi profetik, se Hyji do ta vizitojë popullin e vet. Është pra, ngjarja e pajtimit mes qiellit e tokës, arritje e përkryer e bashkëpunimit mes krijesës dhe Krijuesit, që na mbushë me fe, shpresë e dashuri.

Me mishërimin e Fjalës krijuese në kraharorin e Marisë Virgjër dhe me lindjen e tij në Betlehem, vetë Zoti ka hyrë në historinë e njerëzimit, në rrjedhën e kohëve dhe në ngjarjet e jetëve tona. Që do të thotë: Fjala krijuese e Hyjit ka folur edhe një herë “e u bë njeri”, për të na thënë me të folmen tonë që na do pa masë, e ne ta duam mbi gjithçka për të shpëtuar nga mëkati, e keqja dhe vdekja.

2. Ungjilltarët, sidomos Mateu e Luka, na dëshmojnë se kjo

ngjarje e madhe ka ndodhur në një kohë të caktuar historike, në një vend të saktë geografik, me trashëgimi brezash që dihen dhe në familjen e Jozefit e Marisë që i njohim. Dëshmia tjetër e Ungjilltarëve na thotë se kjo ngjarje ishte e fshehur nga të pushtetshmit, nga të pasurit dhe nga të famshmit e asaj kohe, duke ua zbuluar barinjve të thjeshtë, të vegjël dhe të varfër, para të cilëve një kor engjëjsh këndonte këngën e gëzimit dhe të lavdit, “Lavdi Hyjit në më të lartin qiell e paqe mbi tokë njerëzve që i ka për zemër!” (Lk 2,14).

Foshnja e Betlehemit na fton t’i japim lavdi Hyjit e t’i bashkohemi projektit të madh të Tij krijues për ta ripërtëritë të krijumen, për ta shpëtuar krijesën nga përpirja e së keqes dhe e vdekjes, dhe për të na mësuar të jetojmë denjësisht dhe shenjtërisht mbi tokë. Mbi të gjitha, të bashkëvuajmë për atë që nga mungon e ajo që kemi të mos i mungojë asnjërit nga ne. Kështu do të arrijmë të jemi të vlefshëm për Zotin, kontributdhënës për vendin tonë e të dobishëm për njëritjetrin.

3. Të thelluar në fe dhe në dritën e shpresës që kemi marrë prej Birit të Hyjit të gjallë, guxojmë të shpresojmë dhe të klithim me hare për të mirat që i gëzojmë. Po dhe të jemi mirënjohës për dhuntitë që na i ka dhanë Zoti, për mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar dhe për arritjet



tona e jo të jetojmë si të pashpresë.

Ne që jemi mësuar të shpresojmë, jemi të bindur që Foshnja Hyjnore i mbushë me shpresë të gjitha hapësirat boshe, që brenda nesh i lë bota. Na mëson të shpresojmë në amshim, të durojmë pa kufi, të duam pa interes deri edhe armikun; të dëshirojmë të meritueshmen, të mundshmen,

të dobishmen; ta japim të dhimbshmen, ta sakrifikojmë të posedueshmen, ta marrim barrën e vuajtjes e ta bartim peshën e kryqit.

4. I lutem Foshnjës së Betlehemit që t’i mbushë zemrat e të gjithë njerëzve me dashuri, që të mund të duam njëritjetrin, t’i ndritë mendjet tona që të mund të jemi në shërbim të atyre që kanë nevojë dhe të punojmë për të

mirën e të gjithëve që jetojnë në Kosovë, t’i ngushëllojë të pikëlluarit, ta zbusë dhembjen e të sëmurëve dhe ta dëgjojë vajin e çdo fëmije, që për çfarëdo arsyeje vuan, e sidomos nga pakujdesi ynë.

Për shumë mot Kërshëndellat e gëzuar e me bekime Viti i Ri 2022!

**Ipeshkvi juaj
† Dodë GJERGJI**

FSK-së i shtohen edhe 190 rekrutë të rinj

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

FERIZAJ, 24 DHJETOR - Në Kazermën “Skënderbeu” në Ferizaj të premten është mbajtur ceremonia e betimit të 190 rekrutëve të rinj të FSK-së. Ata janë betuar solemnisht në prani të presidentes Vjosa Osmani-Sadriu, kryeministrit Albin Kurti, ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj, komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, zyrtarëve vendorë e ndërkombëtarë si dhe familjarëve të tyre.

Me këtë rast, presidentja Osmani ka thënë se me rekrutimin e këtyre rekrutëve, FSK-ja përmbyll një vit jashtëzakonisht të suksesshëm të angazhimit dhe të rritjes së saj, gjithnjë konform standardeve profesionale dhe në harmoni me praktikatat e ushtrive moderne. “Secila ditë e certifikimit të ri është e veçantë për ushtrinë dhe për shtetin tonë sepse krahas rritjes së

kapacitetit, FSK-ja po ecën me hapa të sigurt drejt përfundimit të procesit të tranzicionit”, ka thënë Osmani.

Ndërsa kryeministri Kurti ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes e vlerësojnë mbrojtjen dhe sigurinë si shtyllë jetike të shtetit tonë. Ai ka theksuar se do të vazhdojë ta mbështesë FSK-në dhe që përkrah aleatëve tanë strategjikë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të tjera të NATO-s, ta modernizojmë forcën dhe ta bëjmë operacionale dhe të ndërveprueshme me ushtritë e vendeve partnere.

Në fund të kësaj ceremonie komandantja e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjenerabrigade Irfete Spahiu, ka uruar rekrutët për suksesin e dëshmuar gjatë trajnimit si dhe ka shprehur besimin për shërbim dhe karrierë të suksesshme në uniformën e FSK-së.

Certifikimi i 190 ushtarëve të rinj



është proces në kuadër të ngritjes dhe zhvillimit të aftësive

dhe kapaciteteve të nevojshme operacionale, bazuar në planin

gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së.

13 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 24 DHJETOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të premten se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, prej 1 984

testimeve, 13 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të premten janë shëruar

edhe tre qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 991.

Në total numri i rasteve aktive është 331.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 1 530 doza të

vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 662 553 doza të vaksinës. Deri më sot 779 481 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.



Syla kërkon rritje 50 për qind të pagave për punëtorët shëndetësorë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Federata e Sindikatave e Shëndetësisë e Kosovës, pas protestave të organizuar ditë më parë, të premten është takuar me anëtarët e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesindikalisti Blerim Syla ka bërë me dije se urgjent duhet të rregullohet çështja e pagesës së mjekëve dhe infermierëve, ndërsa ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të rriten pagat për profesionistët shëndetësorë për 50 për qind deri të miratohet Ligji për Paga, në të kundërtën ai u shpreh se nëse kjo nuk ndodh nga janari nuk do të mund ta mbajnë nën kontroll stafin shëndetësor për veprimet e tyre.

Ai ka thënë se frustrimi dhe

pakënaqësia në mes të punëtorëve shëndetësorë është rritur edhe pas refuzimeve të ekzekutivit për të diskutuar me ta. "Refuzimi i takimit nga ana e qeverisë ka irrituar punëtorin shëndetësor. Kam frikë se këto ditë përfundojnë dhe vjen janari kur pakënaqësitë rriten, ndërkaq ne nuk jemi në gjendje ta mbajmë situatën në kontroll", ka thënë Syla.

Para anëtarëve të Komisionit të Shëndetësisë, Syla ka thënë se mjekët janë ndierë të ofenduar pasi është vendosur që edhe do ta deklarojnë pasurinë.

Duke folur për Ligjin e Pagave, i cili nuk është buxhetuar as për vitin 2022, kryesindikalisti Blerim Syla ka kërkuar nga anëtarët e këtij komisioni që të bëhet një Ligj i Pagave vetëm për profesionistët shëndetësorë.



Ministri Latifi, mërgimtarëve: Dhurata më e mirë që mund të sillni në Kosovë, të jeni të vaksinuar



PRISHTINË, 24 DHJETOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka dhënë një mesazh për bashkatdhetarët që do të vijnë në Kosovë për festat e fundvitit. Ai ka thënë se dhurata më e mirë për këtë vit që ata mund të sjellin në Kosovë është që të jenë shëndoshë e të vaksinuar.

Ministri Latifi u shpreh se edhe këtë vit festat vazhdojnë të jenë më ndryshe për shkak se pandemia Covid-19 nuk ka përfunduar. "Të dashur bashkatdhetarë, mirë se vini edhe këtë vit në Kosovë për t'i kaluar pushimet fundvitit me të dashurit tuaj dhe të gjithë ne. Edhe këtë vit festat vazhdojnë të jenë pak më ndryshe se në vitet e tjera sepse pandemia Covid-19 ende nuk ka përfunduar. Por, tash kemi në duart tona forcën dhe mënyrën më të mirë të mbrojtjes - vaksinimin. Kjo


është mënyra më e sigurt që në të mbrohemi nga vdekjet dhe komplikimet e rënda shëndetësore të Covid-19. Tani kemi mundësinë të vaksinoheni me dozën e dytë ose të tretë, në aeroportin e Prishtinës, në të gjitha pikat kufitare si dhe në qendrat e vaksinimit në secilën komunë në tërë Kosovën. Ju lus ta shfrytëzoni këtë mundësi. Të festojmë me kujdes, të tregohemi të përgjegjshëm për familjen dhe shoqërinë dhe të mos harrojmë se ne i kemi humbur rreth 3 000 njerëz tanë nga Covid-19. Mos të kemi numra të tillë asnjëherë më në Kosovë. Dhurata më e mirë që ju mund të sillni këtë vit në Kosovë është që të jeni shëndoshë, të vaksinuar dhe të ktheheni shëndoshë andej prej nga vini", thuhet në mesazhin e Latifit.

Haxhiu e procedon në qeveri Projektligjin për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme

PRISHTINË, 24 DHJETOR (ER) - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka njoftuar se kanë proceduar në qeveri Projektligjin për themelimin e byrosë shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme. Haxhiu ka thënë se ky projektligj është punuar nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë të fushës. Me

këtë projektligj, sipas ministres, parashihet verifikimi dhe konfiskimi i pasurisë së pajustificuar të personave zyrtarë, familjarëve të tyre dhe personave të ekspozuar politikisht. "Ky projektligj i cili është punuar nga ekspertët më të mirë të fushës (vendorë dhe ndërkombëtarë) përmban dispozita materiale dhe procedurale të cilat synojnë

verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificuar të personave zyrtarë, familjarëve të tyre dhe personave të ekspozuar politikisht. Njëkohësisht projektligji garanton respektim të të drejtave të palëve në procedurë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe dokumentet ndërkombëtare", ka shkruar ajo në llogarinë e vet në "Facebook".



KDI-ja: Investimet kapitale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, me rrezik të lartë të korrupsionit

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Përmes një konference për medie, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) sot ka paraqitur gjetjet nga analizimi i rreziqeve të lidhura me investimet kapitale publike në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Kjo analizë ka ngritur shqetësime se investimet kapitale në shtetet e rajonit, përveç që janë të cenueshme ndaj korrupsionit, ato përcillen me mbikëqyrje të dobët në zbatim që rrezikon për pasoja afatgjate në shoqëri dhe mjedis.

Është evidente se mosrespektimi i detyrimeve të përgjithshme vlen edhe për kontratat e partneritetit publiko-privat dhe koncesionet. "Përdërisa rreth 40 për qind e buxheteve të këtyre shteteve shpenzohet në investime kapitale, në ndërkohë që Bashkimi Evropian, përmes instrumentit IPA III, ka ndarë

edhe 30 miliardë euro për këto shtete, ku pjesa më e madhe është alokuar për investime kapitale, analiza tregon se investimet strategjike me interes kombëtar rrezikohen nga korrupsioni përmes hartimeve të ligjeve specifike të cilat rritin koston e investimeve, anashkalojnë ligjet e tjera në fuqi. Për më shumë procedurat e hartimit të këtyre ligjeve për investime strategjike përmes marrëveshjeve koncesionare kanë pothuajse zero mbikëqyrje/llogaridhënie dhe transparencë. Po ashtu, këto investime në përgjithësi të realizuara përmes partneriteteve publiko-private dhe koncesioneve ndikojnë negativisht në tregun e lirë duke favorizuar kompani të veçanta, të cilat janë të afërta me pushtetet në fuqi", thuhet në analizën e KDI-së.

Analiza nxjerr të dhëna shqetësuese mbi ndikimet mjedisore e shoqërore që derivojnë pikërisht nga

investimet strategjike në dikasterin e energjisë së ripërtërishtme. "Në vazhdim, investimet në ndërtimin e rrjeteve të ujërave të zeza, në Ballkanin Perëndimor, janë shndërruar në ndotësit më të mëdhenj të lumenjve të rajonit. Analiza ka gjetur se si pasojë e mungesave ligjore, rrjetet e ujërave të zeza rezultojnë të jenë ndotësi kryesor i lumenjve në Ballkanin Perëndimor për shkak se uji nga këto rrjete derdhet në mënyrë të patrajtuar direkt në lumenj. Ligjet e shteteve përkatëse për vlerësimin e ndikimit në mjedis nuk janë obliguese për investimet në ndërtimin e rrjeteve të ujërave të zeza, ndonëse ato parashohin masa për ndërtimin e impianteve që trajtojnë këto ujëra, e që në numër janë tejet të vogla në gjithë rajonin", thuhet në analizën e KDI-së.

KDI-ja ka vlerësuar se ndonëse ndikimi mjedisor dhe socio-ekonomik është tejet i madh, ai anashkalohe tërësisht për

projektet kapitale strategjike, duke lënë vend vetëm për t'u marrë me pasojat e jo edhe me parandalimin e tyre. "Konform problemeve të shpërfaqura, organizatat joqeveritare të rajonit rekomandojnë qeveritë e tyre të jenë llogaridhënëse dhe t'i bëjnë qytetarët e tyre pjesë integrale të vendimmarrjes lidhur me investimet kapitale. Në vazhdim shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia duhet të angazhohen për identifikimin e të gjitha dispozitave ligjore të aplikueshme dhe duhet të angazhohen për krijimin e mekanizmave mbikëqyrës gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të projekteve që të sigurohen për përgjegjshmërinë institucionale dhe kontraktuale", thuhet në këtë analizë.

Po ashtu, thuhet se shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet urgjentisht ta trajtojnë problemin e ndotjes së lumenjve nga rrjetet e ujërave të zeza dhe t'i plotësojnë mangësitë ligjore në vlerësimin

dhe menaxhimin e këtij investimi publik. "Dhe përfundimisht, duke parë se rreziku më i madh ndaj korrupsionit bie mbi investimet strategjike, e të cilat bien në kategoritë e Marrëveshjes së Sofjes dhe mjeteve të ndara përmes IPA III, rekomandojmë që Bashkimi Evropian të vendosë rregulla ndaj shteteve përkatëse për përfshirjen e qytetarëve në këto projekte përmes 'Pakteve të integritetit' të cilat janë instrumente që nxitin dhe garantojnë transparencën, përfshirjen dhe llogaridhënien e institucioneve publike në raport me implementimin e investimeve publike, me theks atyre të financuara nga BE", theksohet në analizën e KDI-së. Kjo analizë është zhvilluar në kuadër të projektit "Sfidat rajonale në luftën kundër korrupsionit dhe keqmenaxhimit të investimeve kapitale" të mbështetur nga Kosovo Foundation for Open Society (KFOS).



BQK-ja thotë se sivjet pati rritje ekonomike prej 9.9-përqindësh

PRISHTINË, 24 DHJETOR - "Viti 2021 konsiderohet vit i suksesshëm për Kosovën. Falë diasporës, politikave të qeverisë dhe rolit të BQK-së, ekonomia e Kosovës u rrit 9.9 për qind", ka thënë guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, në konferencën e fundit për këtë vit. Ai ka thënë se, pavarësisht prej pandemisë,

vendi arriti ta ruajë stabilitetin financiar.

Rritje, sipas Mehmetit, shënuan dhe remitencat, që shkuan mbi 900 milionë euro këtë vit. "Me gjithë vështirësitë, jam i lumtur si guvernator i BQK-së, që në vitin 2021 kemi arritur me sukses t'i arrijmë objektivat. Kemi arritur që ta sigurojmë një sistem

financiar, njëkohësisht kemi qenë shtyllë kryesore e ekonomisë në vend", ka thënë ai, duke shtuar se ka pasur edhe rritje të kërkesës së brendshme dhe të importit. Sipas të dhënave të BQK-së, 265 milionë euro janë investuar nga investitorët e jashtëm, kryesisht në patundshmëri.



Sa e përgatitur është Toka, për përplasjen e mundshme të një asteroidi?



Ndryshe nga sa mund të keni lexuar kohët e fundit, Toka nuk do të shkatërrohet nga asteroidi "Apothis" më 13 prill 2029. As "Bennu", një grumbull mbetjesh hapësinore me gjerësi 535 metra, nuk do të na godasë më 24 shtator 2182.

Çdo histori frikësuese që paralajmëron përplasjen e afërt të një trupit qiellor me Tokën, është thjeshte një përrallë e frikshme. Por njëkohësisht, është e pashmangshme që diçka e tillë të ndodhë një ditë. Dhe kur të ndodhë, ajo mund të gjenerojë zjarre të mëdha, cunami dhe zhdukjen e shumicës së specieve në këtë planet.

"Ky është paradoksi i asteroideve"- thotë Emi Mainzer, eksperte e mbrojtjes planetare në Laboratorin Hënor dhe Planetar të Universitetit të Arizonës, SHBA. Sipas saj shanset për një përplasje të madhe në çdo vit të caktuar janë të vogla, por pasojat e mundshme janë të

mëdha.

Ajo çka e ngatërron më shumë parashikimin, është sesa më i vogël të jetë përplasia, aq më shumë ka të ngjarë që të ndodhë ajo, dhe aq më e vështirë është të parashikohet. Të gjitha këto variabla, e bëjnë shumë sfiduese për shkencëtarë vlerësimin e rreziqet e asteroideve në një mënyrë të dobishme, e cila mund t'i komunikohet edhe publikut.

"Ju nuk keni nevojë të blini një policë sigurimi për asteroidët. Por as nuk ta injoroni plotësisht këtë çështje"- shton ajo. Qendra për Studimet e Objekteve Pranë Tokës (NEO) në laboratorin "Jet Propulsion" të NASA-s, përdor softuerin e simulimit të orbitës të quajtur "Sentry II", për të vlerësuar rrezikun që paraqet çdo asteroid i sapo-zbuluar pranë planetit tonë.

Në më pak se një orë, ai mund të llogarisë shanset e sakta të përplases të një objekti qiellor

brenda 100 viteve të ardhshme, deri në copëzat më të vogla. Baza e saj të dhënave është e hapur për publikun. Ju mund ta verifikoni vetë se asnjë objekt i madh nuk ka ndonjë probabilitet të konsiderueshëm për t'u përplasur me Tokën, të paktën sa të jenë gjallë njerëzit e sotëm.

Por kjo garanci vjen me një paralajmërim të rëndësishëm, sipas të cilit vëzhgimet aktuale të asteroideve nuk janë të plota. Mainzer ka punuar për ta korrigjuar këtë të metë, si drejtuese e NEOWISE, një teleskop hapësinor i ripërdorur i NASA-s, që tashmë po "skanon" qiellin për shkëmbinj hapësinorë të panjohur më parë.

Qershorin e kaluar, NASA autorizoi zyrtarisht NEO Surveyor, me Mainzer në krye. Deri nga mesi i viteve 2030, NEO Surveyor duhet të gjurmtojë mbi 90 për qind të asteroideve potencialisht të

rrezikshëm, me një diametër më shumë se 140 metra.

Astronomët përqendrohen tek ajo përmasë, pasi objekte të tilla janë mjaft të vogla për t'u pikasur gjatë vëzhgimeve aktuale, por mjaftueshëm të mëdha për të shkaktuar dëme të konsiderueshme rajonale. Për asteroidët edhe më të mëdhenj, të aftë të shkaktojnë një shkatërrim në përmasa globale, mbikëqyrja duhet t'i afrohet 100 përqindëshit.


Për të përmirësuar më tej procesin mbikëqyrës, NASA ka sponsorizuar një seri simulimesh të mbrojtjes planetare, në të cilat shkencëtarët pretendojnë se kanë zbuluar një asteroid të ri kërcënues për Tokën. Një ushtrim i realizuar në pranverën e këtij viti nga Vishnu Redi në Universitetin e Arizonës, u bazua në hipotezën se një asteroid i ngjashëm me "Apothis" ishte në një kurs përplasjeje me Tokën.

Pjesëmarrësit në atë simulim ishin të lirë të përpiqeshin të kuptonin se çfarë po ndodhte. Simulimi arriti kulmin me një përplasje vdekjeprurës mbi Republikën Çeke. Fatmirësisht, agjencitë hapësinore të botës po i shtojnë përpjekjet e tyre për të mësuar se si të ndryshojnë trajektoren e një asteroidi të rrezikshëm.

Vitin e ardhshëm, anija kozmike "DART" do të përplasë kokë më kokë në një asteroid me diametër 16 metra të quajtur "Dimorphos", testi i parë i devijimit të një asteroidi. Rreth 4 vjet më vonë, anija kozmike "Hera" e Agjencisë Hapësinore Evropiane do të zhvillojë një studim të ngushtë të efektit të DART mbi "Dimorphos". Misionet e përbashkëta do të përmirësojnë shumë njohuritë tona se si janë asteroidët nga brenda, dhe çfarë do të duhet për të shmangur rreziqet për planetin tonë. Bota.al


EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Kryeministri Kurti: Nuk do të kursejmë për ta përfunduar infrastrukturën e re sportive në Zhegër



GJILAN, 24 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni dhe ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, kanë inspektuar sot vazhdimin e punimeve në palestrën e sporteve në Zhegër, një projekt ky që po realizohet në bashkëfinansim me qeverinë.

Kryeministri Kurti, pasi është njoftuar me ecurinë e punimeve, ka thënë se të premten jemi këtu së bashku me kryetarin e komunës, Alban Hyseni dhe ministrin Hajrullah Çeku, që t'i përgëzojmë punëtorët dhe kompaninë për këtë fillim apo rifillim të punës në këtë infrastrukturë shumë të rëndësishme sportive për Zhegërën e për Gjilanin. Ai ka premtuar se ky projekt i nisur ka herë dhe i lëmë në gjysmë, tani që po rifillon, do të kryhet me sukses, për çka ka njoftuar se janë

ndarë edhe fondet e nevojshme dhe pardje është nënshkruar edhe kontrata. "Do të ndajmë fonde që një punë e nisur moti dhe e lënë përgjysmë, ku operatori ekonomik është tërhequr, rast ky i rrallë dhe mbase edhe i vetëm, ta përmbyllim suksesshëm, sepse jo vetëm historisë dhe ekonomisë sonë, por edhe kulturës sonë, Zhegra i ka dhënë shumë", ka nënvizuar kryeministri Kurti. Prandaj, ka vijuar ai, ne e kemi për obligim të investojmë këtu dhe kësaj shprijmë edhe sportin përpara, gjithashtu edhe aktivitetin shoqëror të këtij vendi në përgjithësi. Duke e nënvizuar rëndësinë e sportit, si kulturë e popullsisë dhe si shëndet, kreu i qeverisë ka thënë se kjo ka nevojë edhe për infrastrukturë të re. "Meqenëse sporti nuk është vetëm për sportistët, por është për të gjithë

sportdashësit e ne e dimë, sidomos nga koha jonë, se sporti është edhe shëndet, andaj kemi interes që sportin ta bëjmë edhe kulturë të popullsisë dhe kjo infrastrukturë e re, për të cilën ne nuk do të vonojmë e kursejmë, do të ndihmojmë shumë në këtë drejtim", ka thënë Kurti.

Përndryshe, kryetari i komunës, Alban Hyseni, ka thënë se vlera e këtij projekti është 1.2 milion euro dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2022 për t'ua dhënë mundësi sportistëve dhe sportdashësve të këtij lokaliteti të madh të Grykës së Karadakut që aktivitetet sportive t'i zhvillojë e t'i ndjekë në një objekt bashkëkohor. Palestra ka kapacitet prej 800 ulëseve dhe i plotëson nevojat e këtij lokaliteti, i cili ka edhe një klub hendbolli që garon në Superligën e Kosovës.

SHKURT

Ndeshja Kosovë - Norvegji zhvillohet në Mitrovicë

Federata e Basketbollit e Kosovës në mbledhjen e mbajtur ka marrë një sërë vendimesh, ndërsa ka vendosur që ndeshja ndërkombëtare Kosovë - Norvegji të luhet në Palestrën "Minatori" në Mitrovicë. "Bordi i Federatës i Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e mbajtur më 23.12.2021 në Prishtinë ka vendosur që ndeshja Kosovë - Norvegji, në kuadër të parakualifikimeve për FIBA Eurobasket 2025 më 27 shkurt 2022, të zhvillohet në palestrën 'Minatori' në Mitrovicë", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Napoli e dëshiron transferimin e Kumbullës në janar

Napoli është skuadra që kërkon shërbimet e mbrojtësit shqiptar të Romës, Marash Kumbulla. Mediet italiane në rubrikën e merkatos e kanë si lajm kryesor, teksa Napoli është futur në negociata për ta përforcuar repartin e prapavijës. Pas largimit të Kostas Manolas dhe angazhimit të Kalidou Koulibaly në Kupën e Afrikës, synim i Napolit është blerja e një qendërmbrojtësi. Parametrat mbeten ato të merkatos verore: një operacion huazimi me të drejtë blerjeje. Mbrojtësi i kombëtares shqiptare është kërkuar edhe më herët nga Napoli, por ishte Roma ajo që bleu kartonin nga klubi i Veronës. Interesim për shërbimet e tij ka treguar edhe Torino.

Covidi shtyn edhe një ndeshje në Premierë Ligë

Një tjetër ndeshje në futbollin anglez nuk do të zhvillohet sipas orarit të planifikuar. Ndeshja e "Boxing Day" mes Evertonit dhe Burnleyt është shtyrë nga Premierë Liga e cila është e vlefshme për javën e 18. Faqja zyrtare e Burnleyt shkruan për njoftimin e Premierë Ligës dhe aprovimin e kërkesës së Evertonit për ta shtyrë ndeshjen. Evertoni ka disa raste me Covid-19 në skuadër me një valë të madhe që rrezikon edhe lojtarët e tjerë. Edhe dy ndeshje të tjera, përfshirë atë të Liverpoolit, janë shtyrë si pasojë e arsyes së njëjtë.

Palko e Partizanit, MVP e xhiros së pestë

Xhiroja e pestë që u zhvillua në mesjavë ka sjellë ndeshjet e fundit për stinorin vjeshtor në Ligën Unike të Femrave. Basketbollistja e Partizanit, Aida Palko, ka zhvilluar një ndeshje të jashtëzakonshme kundër Tiranës, me 40 pikë, 22 kërcime dhe shtatë asistime,

duke e pasur indeksin e lojës 60, apo dukshëm më të lartën për xhiron e pestë në Ligën Unike, duke u shpallur basketbollistja më e mirë e ndeshjes dhe javës. Ajo u ndihmua nga Dajana Baraj me 21 pikë, pesë kërcime dhe nëntë asistime. Flamurtari

shënoi fitore ndaj Prishtinës 64:57, ku lojtarja më e dalluar në parket ishte Obryan Michelle me dyshifror të trefishtë, 16 pikë, 16 kërcime dhe dhjetë asistime. Penza triumfoi në derbin ndaj Bashkimit, duke u shpallur kampione vjeshtore, ndërsa te

skuadra pejane u dallua dyshja Valbona Bytyqi dhe Rael Whitsitt. Bytyqi ndaj Bashkimit realizoi 24 pikë, tri kërcime dhe katër asistime, kurse Whitsitt kontribuoi me 20 pikë, 19 kërcime dhe tri asistime. Top pesëshja: Aida Palko (Partizani) 40 pikë, 22 kërcime,

7 asistime, Obryan Michelle (Flamurtari) 16 pikë, 16 kërcime, 10 asistime, Valbona Bytyqi (Penza) 24 pikë, 3 kërcime, 4 asistime, Rael Whitsitt (Penza) 20 pikë, 19 kërcime, 3 asistime, Dajana Baraj (Partizani) 21 pikë, 5 kërcime, 9 asistime.

NBA urdhëron lojtarët ta marrin dozën e tretë brenda 31 dhjetorit

WASHINGTON, 24 DHJETOR - NBA ka bërë me dije se që kur ka nisur sezoni 2021-2022 rastet me koronavirus kanë qenë të shumta, aq sa 25% e lojtarëve janë infektuar apo kanë hyrë në protokollin e sigurisë. Kjo do të

thotë që 1 nga 4 lojtarë është detyruar të karantinohet për disa ditë. Kjo situatë ka bërë që disa ndeshje të këtij sezoni të shtyhen për më vonë, duke bërë që kalendari të ndryshojë. Ndërkohë, mësohet se NBA u

ka dërguar një urdhër skuadrave që brenda datës 31 dhjetor të gjithë lojtarët ta marrin dozën e tretë të vaksinës kundër Covidit. Dozën e tretë do të kryejnë edhe stafet e skuadrave si dhe familjarët e

tyre, për të evituar që situata me pandeminë të përkeqësohet në NBA. Gjithashtu, periudha e karantinës mund të ulet nga 10 në 7 ditë, ashtu sikurse ndodh edhe në NFL, me kusht që lojtari të dalë negativ.



FBK-ja për herë të parë jep çmimin për basketbollistin dhe basketbollisten e stinorit vjeshtor

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) për herë të parë do ta japë çmimin e basketbollistit dhe basketbollistes më të mirë për stinorin vjeshtor në Art Motion Superligë, përkatësisht Superligën e Femrave. Por, ky çmim do të jepet sipas votimit nga tifozët e basketbollit. Ata kanë mundësi të votojnë në uebfaqen zyrtare të FBK-së dhe të përzgjedhin më të mirin ose më të



mirën e stinorit vjeshtor. Në bazë të rezultateve të skuadrave në Art Motion Superligë dhe paraqitjes së lojtarëve, top pesë lojtarët e përzgjedhur janë: Dardan Berisha (Peja), Ivan Koljeviq (Prizreni 16), Erjon Kastrati (Golden Eagle Ylli), Drilon Hajrizi (Trepça) dhe Julien Lewis (Bashkimi).

(Prishtina), Valbona Bytyqi (Penza), Arbnore Përçuku (Prishtina), Rael Whitsitt (Penza) dhe Irma Konjusha (Bashkimi). Votimi për basketbollistin dhe basketbollisten më të mirë të stinorit vjeshtor do të jetë i hapur deri më 31 dhjetor 2021 (ora 16:00), ku do të numërohen votat dhe do të shpallet më i/e miri/mira nga tifozët. Vetëm një herë mund të votojnë për një lojtar ose lojtare.

MESHKUJT

Dardan Berisha	(Peja)
Ivan Koljeviq	(Prizreni 16)
Erjon Kastrati	(Golden Eagle Ylli)
Drilon Hajrizi	(Trepça)
Julien Lewis	(Bashkimi)

FEMRAT

Sarah Mgbeike	(Prishtina)
Valbona Bytyqi	(Penza)
Arbnore Përçuku	(Prishtina)
Rael Whitsitt	(Penza)
Irma Konjusha	(Bashkimi)

Ish-shefi i Formulës 1: Hamiltoni mund të mos kthehet në pistë më 2022

LONDËR, 24 DHJETOR - Bernie Ecclestone kthehet të flasë për të ardhmen e Lewis Hamiltonit. Sipas ish-padroneit të Formulës 1, shtatë herë kampioni i Botës mund të mos kthehet të garojë më 2022. 91-vjeçari britanik deklaroi se ka folur pak ditë më parë me Anthony'n, babanë e Lewisit, i cili, sipas tij, nuk u është përgjigjur pyetjeve në lidhje me të ardhmen e pilotit të Mercedesit, me Ecclestone që u shpreh se "folëm vetëm për biznes". Për sa i përket vitit 2022 të pilotit, Ecclestone deklaroi se ai nuk di asgjë, por nuk beson se



Hamiltoni do të rikthehet në pista. "Pasi zhgënjimi i tij është shumë i madh, dhe kjo është e kuptueshme. Me 7 tituj botërorë, aq sa ka edhe Schumacheri, tani për Hamiltonin është momenti ta realizojë ëndrrën e tij për t'u bërë një sipërmarrës në botën e

modës". Më pas Ecclestone u ndal në finalen e garës së Abu Dhabit që i dorëzoi titullin botëror të Formulës holandezit Max Verstappen. "Drejtori i garës, Masi, mund t'i kishte kursyer ca telashe nëse do ta kishte ndërprerë menjëherë garën me flamurin e kuq pas incidentit. Pastaj do të kishte një superfinale mes Maxit dhe Lewisit për tri xhirot e fundit. Masi natyrisht që është fajtor edhe për këtë sot. Shumë gjëra shkuan keq, por tani nuk mund t'i ndryshojmë".

SHKURT

Bach: Nëse e përfshijmë politikën në sport, atëherë ky do të ishte fundi i Olimpiadës

Janë disa shtete që kanë vendosur t'i bojkotojnë diplomatikisht Lojërat Olimpikë dimërore "Pekin 2022", ngjarje që do të zhvillohet në shkurt në Kinë. Këto shtete nuk do të dërgojnë përfaqësi politike në ceremoninë e hapjes, pasi kritikojnë Kinën për shkelje të të drejtave të njeriut. Kjo situatë ka detyruar presidentin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach, të ndërhyjë, duke i kërcënuar të gjitha vendet. Ai e konsideron si të patolerueshme situatën e krijuar, duke bërë apel që vendet të merren me sport gjatë Olimpiadës dhe t'i evitohen konfliktet politike.

"Nëse ne do të merreshim me politikë nuk do të kishim në gjirin tonë 206 komitete olimpikë anëtare që marrin pjesë në Olimpiadë. Lojërat Olimpikë nuk merrem me politikë, por me sport. Nëse e përfshijmë politikën në sport, atëherë ky do të ishte fundi i Olimpiadës, nuk do të kishte më Lojëra Olimpikë", ka deklaruar Bach.

Barcelona planifikon transferimin e De Ligit

Barcelona është duke planifikuar transferimin e mbrojtësit të Juventusit, Matthijs de Ligt, në afatin kalimtar të verës. "Barcelona po mendon seriozisht që të transferojë De Ligt në La Liga. Kjo hipotezë është praktikisht e pamundur për shkak të rrogës së lartë të mbrojtësit. Por ndryshon mendimi për merkaton e verës, sepse Juventus do të përpiqet ta shesë që të investojë në sulm", shkruajnë mediet iberike. Çmimi i kartonit të lojtarit do të ishte më i ulët se 120 milionët që parashikohen në kontratë.

Unitedi nuk e shtet Pogbën

Paul Pogba është në vitin e fundit të kontratës me Manchester Unitedin, që deri më tani ka refuzuar ta rinovojë kontratën me "Djajtë e Kuq". Për këtë është raportuar që për të mos e humbur me parametra zero, United mund ta shesë në janar. Por, mediet britanike raportojnë se Manchesteri nuk e ka ndër mend ta lërë të largohet mesfushorin francez, i cili që nga korriku e ka në tavolinë ofertën për rinovimin e kontratës. Pogba ende s'e ka thënë fjalën e fundit dhe Unitedi po e pret një përgjigje përfundimtare. Reali dhe PSG-ja janë skuadrat favorite për ta rrëmbyer mesfushorin. Nuk përjashtohet asnjë rikthim në Juventus.

Bayerni dhe Chelsea në garë për Dest

Sergino Dest pritet të jetë ndër lojtarët e parë që do të largohet nga Barcelona gjatë afatit kalimtar dimëror. Mbrojtësi i djathtë amerikan është nxjerrë në shitje nga Barcelona që ka nevojë urgjente për para. Gjiganti katalunas i ka vendosur çmimin e largimit amerikanit prej 30 milionë eurosh. "Daily Mail" ka raportuar se Chelsea së fundmi i është bashkuar garës me Bayern Munichun për t'i fituar shërbimet e Destit. 21-vjeçari ka pasur probleme me lëndime, por do të largohet nga "Camp Nou" gjatë janarit për t'i mbushur arkat e klubit katalunas. Chelsea është e gatshme ta ofrojë shumën e 30 milionë eurove për lojtarin, por ofertë të ngjashme pritet të bëjë edhe Bayerni. Katalunasit janë të kënaqur me shumën prej 30 milionë eurove, pasi në verën e vitit 2020 kishin shpenzuar 21 milionë euro për ta blerë atë nga Ajaxi.

Inzaghi: Doja ta evitoja Liverpoolin në Ligën e Kampionëve

Pavarësisht prej shtatë fitoreve radhazi në kampionat, Simone Inzaghi bekon pushimet e Vitit të Ri, teksa gjatë një interviste me të përditshmen sportive italiane "La Gazzetta dello Sport", trajneri i Interit ka

deklaruar se duhet të tregojmë kujdes ndaj Juventusit në fazën e dytë dhe se do të donte ta evitonte Liverpoolin në fazën e 1/8-ve të Ligës së Kampionëve: "Ekipi duhet të shpëtohet. Lojtarët gjatë pushimeve do

të marrin shumë shpejt një program nga përgatitësit atletikë dhe do ta ndjekin me shumë përqendrim. Mendoj se Juventus do të bëjë një fazë të dytë të madhe, dhe në atë kohë duhet të kemi kujdes ndaj saj. Humbja me

Lazion në transfertë? Çdo humbje normalisht që të dëmton, por mund të dalësh më i fortë nga ajo goditje. Që kur kanë filluar opsionet me pesë zëvendësime kam pasur shumë kujdes në atë aspekt". "Liverpooli? Jemi të

vetëdijshëm se çfarë ndeshje na pret. Do të doja ta evitoja Liverpoolin. Skuadra duhet të jetë shumë intensive në atë sfidë, por përpara atij takimi do të kemi plot ditë të gjata të përjetuara intensivisht", ka deklaruar Inzaghi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 24.12.2021 bënë shpallje publike për dhënie të pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-21-010

Qëllimi i ofertës:	Dhënie me qira e hapësirave – Depoja Plastike - Industria e baterive
Kriteret e Dhënies:	Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Periodha:	3 (tre) vite me mundësi vazhdimi
Data e shpalljes:	24.12.2021
Sqarimi:	deri me 06.01.2022
Kërkesa për pjesëmarrje:	Data(t) për kërkesës deri: 06.01.2022 Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.
Siguria e ekzekutimit:	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit 3 (tri) pagesa mujore nga vlera e përgjithshme e kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej 3 vite nga data e nënshkrimit të kontratës.
Dorëzimi i ofertave:	Dorëzimi i ofertave bëhet në formë fizike (zarf të mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit:	11.02.2021 në 10:00
Vendi i dorëzimit:	Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku industrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: sales@trepcacorporation.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcacorporation.com		



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 23.12.2021, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësim të vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 25.12.2021, të shpallë;

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës:

Zyrtar/e për Projektim dhe Zhvillim - me kohë të pacaktuar

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Harton strategjinë zhvillimore të kompanisë të mbështetur në planin strategjik të Bordit të Drejtorëve;
- Harton projektet të ndara sipas nevojës dhe kërkesës së Ekzekutivit;
- Bënë zbatimin dhe zhvillimin e projekteve të kompanisë;
- Bënë mirëmbajtjen e sistemit të të dhënave të projekteve të kompanisë;
- Ndhmon në menaxhimin , përditësimin e bazës së të dhënave të projekteve të kompanisë në kohë dhe mënyrë profesionale;
- Kryen detyrat e dhëna në kohë dhe mënyrë profesionale;
- Ruan dokumentacionin dhe procedurat e sakta dhe të plota të identifikuar për të gjithë projektin(hapat) në lidhje me funksionalitetin;
- Përpilon planin vjetor të punës dhe përcjellë realizimin e të njëjtit;
- Kryen edhe të gjitha punët tjera të kësaj natyre dhe punë tjera që i cakton eprori i drejtëpërdrejtë .

Kushtet , aftësitë dhe njohuritë e kërkuara:

- CV-në
- Të ketë Diplomë Universitare
- Aftësi organizative, planifikuese dhe kordinuese
- Preferohet njohja e gjuhëve të huaja
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj.mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti"Sh.A.Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 25.12.2021 deri më datën 08.01.2022. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues.Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Besart Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

